
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data:06.08.2026

Procesverbal – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**“BLERJE PAJISJE PËR INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SOCIAL” I NDARË
NË 3 (TRE) LOTE.**

- **LOTI 1. “BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM”**
- **LOTI 2. “BLERJE PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE”**
- **LOTI 3 “BLERJE PAJISJE KONDICIONIMI”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Televizor me ngjyra- 32324100-1 Artikuj mobilimi- 39516000-2, Fshesa- 39224100-9
Frigorifere- 39711130-9, Lavatrice dhe tharese rrobash- 39713200-5, Pajisje te ajrit te
kondicionuar- 39717200-3, Furra gatimi- 42214100-0 , Bolier ngrohës - 42515000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 34,003,515 (tridhjetë e katër milion e tre mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 364,845 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e pesë) EURO pa TVSH i ndarë në 3 lote si më poshtë vijon:

- **Loti 1. “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim”** me fond limit 24,054,327 (njëzet e katër milion e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH ose 258,094 (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e katër) EURO pa TVSH.
- **Loti 2. “Blerje pajisje elektroshtëpiake”** me fond limit 2,736,000 (dy milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose 29,356 (njëzet e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) EURO pa TVSH.
- **Loti 3 “Blerje pajisje kondicionimi”** me fond limit 7,213,188 (shtatë milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 77,395 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) EURO pa TVSH.

*Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 06.08.2026, me kurs këmbimi 93.20 (nëntëdhjetë tre pikë njëzet) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar për secilin lot, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Shërbimi Social Shtetëror janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI 1. “BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë

jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera,

nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetorë, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetorë së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi loti 1 ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. *Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / broshurave / skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kjo kerkese ka disa avantazhe pasi permbushja e saj siguron besueshmëri te informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Garanton gjithashtu përputhshmërinë me specifikimet teknike ç’ka siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Kërkesa për përmbushjen e këtij kriteri gjithashtu redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara. Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog/broshurë/skede teknike do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.3 Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të disponojë stafin me kualifikimet si më poshtë:

Të paktën 1 (një) inxhinier druri, në rast se është prodhues vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

Të paktën 2 (dy) marangozë/ mobilier/ montues mobiljesh vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Të paktën 4 (katër) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shenim: Kriteri nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Punonjësit me specialitetet e sipërpërmendura kërkojnë në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Edhe pse procedura është e tipit “Blerje/furnizim mobiljesh”, objektet e prokurimit nuk janë produkte standarde të gatshme, por mobilje që kërkojnë prodhim, montim dhe përshtatje sipas specifikimeve teknike të tenderit dhe të ambjentit të AK përfitues. Thënë kjo këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkojnë nga Autoriteti Kontraktor, pra kjo kontrate ka si proces prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Për këtë arsye, prania e stafit të kualifikuar është e domosdoshme për garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat e kontratës. Inxhinieri i drurit është i nevojshëm për të siguruar projektimin teknik, përzgjedhjen e materialeve dhe mbikqyrjen e procesit të prodhimit/montimit, duke garantuar që mobiljet të jenë ergonomike, funksionale dhe të përputhshme me standardet e sigurisë. Pa këtë profil, rrezikohet cilësia dhe jetëgjatësia e produkteve të furnizuara. Ky proces

nuk është thjesht dekorativ, por lidhet drejtpërdrejt me rezistencën e mobiljeve ndaj konsumit dhe faktorëve mjedisorë, duke siguruar që produkti final të jetë i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm për përdorim afatgjatë në administratë publike. **Gjithashtu kjo kërkesë është kërkuar vetëm për rastet kur ofertuesi është prodhues mobiljesh dhe jo në rastet kur ai është vetëm tregëtues i tyre.**

Objekti i kontratës përfshin furnizimin dhe dorëzimin e mallrave në ambientet e AK përfitues. Për realizimin e sigurt, korrekt dhe brenda afateve të kontratës së procesit të transportit, ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave operatori ekonomik duhet të disponojë personel të mjaftueshëm të specializuar për kryerjen e këtyre proceseve. Prania e punonjësve të ngarkim-shkarkimit është e domosdoshme për garantimin e lëvizjes së mallrave pa dëmtime, respektimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, përmbushjen e afateve të dorëzimit, shmangien e ndërprerjes së vonesave gjatë ekzekutimit të kontratës. Për këtë arsye kërkesa për disponimin e punonjësve të ngarkim shkarkimit konsiderohet e nevojshme për të garantuar ekzekutimin cilësor të sigurt dhe në kohë të kontratës. Numri i kërkuar për punonjësit e ngarkim shkarkimit është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, afatin e realizimit të kontratës prej 30 ditësh si edhe faktin që furnizimi do të kryhet në 13 institucione të përkujdesit social të shpërndara gjeografikisht në zona të ndryshme të territorit të Republikës së Shqipërisë. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me realizimin e kontratës pasi mobiljet duhet të shkarkohen dhe vendosen në ambientet e secilit institucion duke respektuar afatin kontraktor. Numri i kërkuar është proporcional me volumin e furnizimit dhe shpërndarjen gjeografike të tij dhe nuk krijon kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e ofertuesve të mundshëm ekonomikë. Në vijim në kërkesat për kualifikim është kërkuar që OE të mundshëm ekonomikë të disponojnë 2(dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh duke qënë se artikujt objekt prokurimi do të montohen dhe instalohen në ambientet e Ak përfitues. Këto artikuj do të fiksohen montohen dhe nëse nuk është një staf i specializuar atëherë kjo mund të ndikojë në cilësinë, sigurinë dhe jetgjatësinë e mobiljeve. Numri i kërkuar për marangozë është minimal dhe i domosdoshëm për realizimin e procesit të montimit brenda afatit kohor kontraktual dhe në të gjitha institucionet e përcaktuara në pikën 2.12 të DST.

Ky numër punonjësish është numri minimal që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësore, të qëndrueshme dhe jetëgjata, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit. Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, objektin ku do të kryhet furnizimi, vendosja/monitimi dhe kolaudimi i mallrave objekt prokurimi si dhe afatin e lëvrimit të mallit. Pra, kërkesa për këto profile nuk është e tepruar, por proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën e objektit të prokurimit, siç parashikohet në LPP dhe RPPP. Këto kërkesa janë vendosur për të krijuar bindjen se kontrata do të realizohet me sukses sipas standardeve të cilësisë dhe funksionaliteteve të kërkuara. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit loti 1, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit

të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues potencial sipas nevojave të tyre.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI 2. “BLERJE PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimi e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c)

40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi loti 2 ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 "Formulari i Specifikimeve Teknike", në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / broshurave / skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kjo kërkesë ka disa avantazhe pasi permbushja e saj siguron besueshmëri të informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Garanton gjithashtu përputhshmërinë me specifikimet teknike ç’ka siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Kërkesa për permbushjen e këtij kriteri gjithashtu redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog/broshurë/skede teknike do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit loti 2, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikatatë të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë për pajisjet objekt prokurimi loti 2 konform përcaktimit të bërë në specifikimet teknike duke nisur nga data e lëvrimit të tyre dhe gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se artikujt e ofruar janë cilësorë dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues potencial sipas nevojave të tyre.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI 3 "BLERJE PAJISJE KONDICIONIMI"

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përllëgaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset

konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi loti 3 ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 "Formulari i Specifikimeve Teknike", në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / broshurave / skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin

e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kjo kerkese ka disa avantazhe pasi permbushja e saj siguron besueshmëri te informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Garanton gjithashtu përputhshmërinë me specifikimet teknike ç'ka siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Kërkesa për përmbushjen e këtij kriteri gjithashtu redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kerkese, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog/broshurë/skeda teknike do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”/ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit loti 3, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikatatë të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues potencial sipas nevojave të tyre.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN E PARE ME OBJEKT: BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM” NDODHEN BASHKENGJITUR DOKUMENTAVE STANDARTE TE TENDERIT.

Shenim* Referencat ndaj standarteve EN do të konsiderohen të plotësuar edhe në rastet kur produkti ose materiali është i çertifikuar sipas standartit ekuivalent SSH EN i adoptuar si standart shqiptar për sa kohë standarti është teknikisht identik ose ekuivalent me standartin EN të kërkuar.

SPECIFIKIMET TEKNIKE LOTI 2 “BLERJE PAJISJE ELEKTROSHTETIAKE

Nr .	Emertimi	Specifikmet teknike
1	Frigoriferë të vegjël	Tipi I Frigoriferit :Minibar, Lloji I ftohjes : me akull,Klasi I energjise: min A+ ,Kapaciteti Neto(Ngriresi/Freskuese): min 80 litra, Permasat (Gjxlxth)(cm): min 48x45x85,Materiali i rafteve :plastik ,Garancia : min 24 muaj.
2	Televizor 43``	Permasat 43``,Paneli Led,Frekuenca min HZ50,Smart Tv po,Sistemi Operativ Tizen,Wirless Po,Blootooth Po,Marresi DVB-C/T2/S2,Moduli CI+(1.4),Konsumi Standby(Watt) max 0 .5,Permasat min 96.75x60.97x19.1, Garancia min 24 muaj.
3	Tharëse rrobash 9 kg	Tharese pompe nxehtesie min 9 kg , A+ ose ekuivalente ,max 258kwh, max 65db, min (Gjatesia 595mm, lartesia 849mm,thellesia 649 mm), garancia min 24 muaj.
4	Lavatriçe 10 kg	Kapaciteti min 10kg, Klasi i energjise min A+,Centrifuge me efikasitet te larte min 1400 rpm,kosh i gjere dhe i madh min 10 kg, garancia min 24 muaj
5	Lavatriçe 18 kg	Programet min 10, Ekrani digjital Po Permasat min H 98.4xP 68.6x D 89.8 cm, Kapaciteti I ngarkeses min 18 Kg ,Shpejtesia e Centrifugimit e lartë, Bllokimi per femije Po ,Vonesa kohore Po,Vleresimi i energjise C,lloji i daulles SWIRL,Niveli i zhurmes max 72dB,Konsumi Vjetor i energjise max 80 kwh per 100 cikle. Garancia min 24muaj

6	Frigorifer 500lt	Vellimi i pergjithshem bruto min 500 lt, Ftohje/shkrirje , ventilator i dyfishte ftohes, kapaciteti ngrires min 145 lt, teknologjia e ngirjes e shpejte, mbyllje anti-bakterjale,bllokim prinderor,njoftim i deres se hapur, niveli i zhurmes max 38dbA, konsumi i energjise max 195 Kwh/vit , konsum A+ ose ekuivalente , permasat min 190x70x75, gama e lartesisë min 181-200cm, lloji i ftohjes FullNo frost, garancia min 24 muaj.
7	Sobë gatimi me gaz dhe korent	Tavoline pune me linja te rrumbullakosura, Kapak xhami,min 5 ndezes me unaze qendrore, Ndezje automatike me buton shtypes te forta me rozete, Kohematesi mekanik i minutave me sinjal akustik,Furre elektrike shumefunksionale me min 8 programe gatimi, Dera e fures me min 3 gota te brendshme dhe zgaver te emaluar ,Pastrohet lehte ,Permasat min WxDxH 90x60x85-90, Garancia min 24muaj
8	Frigorifer banak ngrirës	Tipi i vendosjes: Qendrim i lire, Ngjyra/Materiali: Metalik, Lloji i ftohjes: MinFrost, Kapaciteti total: min 310 l, Paneli i kontrollit: Mekanik, Opsione Ekstra: MultiZone ose ekuivalente, Klasi i energjise: min A+, Mbrojtja e ushqimeve: MinFrost, Kapaciteti NETO (Ngriresi/Freskuesi): min 300, Kompresori: ProSmart Inverter ose ekuivalente, Niveli i zhurmes (dBA): max 42, Permasat min(Gj x L x Th) (cm): 110 x 85 x 70 Garancia min 24muaj
9	Frigorifer kollon	Frigorifer freskues kollone, Kapaciteti neto: min300L, Ndriçim i brendshëm LED, Përmasat: min 185x70x50 cm, Shpenzimet e energjisë: max 227 kWh /vit, Niveli i zhurmës: max 35 dB Garancia min 24muaj
10	Fshesë me korent	Tipi: Fshese me korent,Kapaciteti: min 1.5 lt,Pesha min 5 kg,Lloji i depozitimit te pluhurit gote,Tipi I filtrit Allergy HEPA H13 ose ekuivalent,Funksion larje/ pastrimi për sipërfaqe të ndryshme, Garancia min 24muaj.
11	Bolier uji	Lloji : Bolier elektrik Horizontal, Kapaciteti ne litra : min 80 litra, Permasat sipas modelit të prodhuesit,Material i brendshem:Enamel ose ekuivalent, Sistem stakues : Po, garancia min 24 muaj.
12	Aspirator me shinë	Kapaciteti min 300 m3/orë,masa min 60x18x12cm,Ndricimi i integruar min 2 drita,Tensioni 220-240V,fuqia sipas standarteve të prodhuesit,garancia min 24 muaj
13	Furrë inkaso	Lloji:Furre + Suprine,Kapaciteti min 70 L, Paneli i kontrollit mekanik ,Ekрани Lcd Led, Vetpastrim Po, Menyra e hapjes normale, Klasi i enrgjise min A+, Garancia min 24 muaj, menyra e pjekjes Elektornike min 6 funksione
14	Pianurë	Nr i zonave te gatimit min 4,Tipi Induksion, Paneli i kontrollit me prekje, garancia min 24 muaj

SPECIFIKIMET TEKNIKE : LOTI 3 BLERJE PAJISJE KONDICIONIMI

Nr .	Emertimi	Specifikmet teknike
------	----------	---------------------

1	Kondicioner Inverter mural 9000 BTU/h	Kondicioner Inverter Mural 9000 BTU/h; Kapaciteti termik Ftohje Mesatar: 2.5 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Mesatar 3.6 kW; Fuqia elektrike 0.40-0.62 kW; SEER=9.36-9.54, SCOP=5.1-5.9; EER=4.5-6.1; COP=4.65-5.8; Sasia e ajrit Mesatar ftohje: 310-470 m³/h; Sasia e ajrit Mesatar ngrohje: 350-490 m³/h; Niveli Zhurmës Minimumi 20-26 dB(A); Temperatura e punës Minimumi -15°C; Klasi Energjisë A+++ / A++ gaz R32, wifi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN/ISO Standard Compliance – zakonisht përputhshmërinë me standardet europiane si EN 14511, EN 378, EN 14825 (efikasitet energjetik, siguria e sistemeve ftohëse). RoHS / WEEE – për kufizimin e substancave të rrezikshme dhe riciklimin (fletët e pajtueshmërisë (Declaration of Conformity – DoC) nga prodhuesi. Pajisja duhet të ketë CE, ErP, etiketë energjetike dhe/ose deklarata konformiteti.
2	Kondicioner Inverter mural 12000 BTU/h	Kondicioner Inverter Mural 12000 BTU/h; Kapaciteti termik Ftohje Mesatar: 3.5 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Mesatar 5 kW; Fuqia elektrike 0.66-1.0 kW; SEER=8.7-9.1, SCOP=5.2-5.77; EER=5.1-5.35; COP=4.8-5.1; Sasia e ajrit Mesatar ftohje: 300-336 m³/h; Sasia e ajrit Mesatar ngrohje: 340-420 m³/h; Niveli Zhurmës Minimumi 20-30 dB(A); Temperatura e punës Minimumi -15°C; Klasi Energjisë A+++ / A++ gaz R32, wifi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN/ISO Standard Compliance – zakonisht përputhshmërinë me standardet europiane si EN 14511, EN 378, EN 14825 (efikasitet energjetik, siguria e sistemeve ftohëse). RoHS / WEEE – për kufizimin e substancave të rrezikshme dhe riciklimin (fletët e pajtueshmërisë (Declaration of Conformity – DoC) nga prodhuesi. Pajisja duhet të ketë CE, ErP, etiketë energjetike dhe/ose deklarata konformiteti.
3	Kondicioner Inverter mural 14000 BTU/h	Kondicioner Inverter Mural 14000 BTU/h; Kapaciteti termik Ftohje Mesatar: 4.3 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Mesatar 5.4 kW; Fuqia elektrike 1.15-1.35 kW; SEER=7.7-8.0, SCOP=4.4-4.55; EER=3.5-3.7; COP=4.8-5.1; Sasia e ajrit Mesatar ftohje: 500-770 m³/h; Sasia e ajrit Mesatar ngrohje: 600-800 m³/h; Niveli Zhurmës Minimumi 20-30 dB(A); Temperatura e punës Minimumi -15°C; Klasi Energjisë A+++ / A++ gaz R32, wifi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN/ISO Standard Compliance – zakonisht përputhshmërinë me standardet europiane si EN 14511, EN 378, EN 14825 (efikasitet energjetik, siguria e sistemeve ftohëse). RoHS / WEEE – për kufizimin e substancave të rrezikshme dhe riciklimin (fletët e pajtueshmërisë (Declaration of Conformity – DoC) nga prodhuesi. Pajisja duhet të ketë CE, ErP, etiketë energjetike dhe/ose deklarata konformiteti.
4	Kondicioner Inverter mural 18000 BTU/h	Kondicioner Inverter Mural 18000 BTU/h; Kapaciteti termik Ftohje Mesatar: 5.0 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Mesatar 6.3 kW; Fuqia elektrike 1.10-1.41 kW; SEER=7.2-8.7, SCOP=4.3-5.6; EER=3.09-4.55; COP=3.5-4.47; Sasia e ajrit Mesatar ftohje: 500-865 m³/h; Sasia e ajrit Mesatar ngrohje: 580-995 m³/h; Niveli Zhurmës Minimumi 30-40 dB(A); Temperatura e punës Minimumi -15°C; Klasi Energjisë A+++ / A++ gaz R32, wifi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN/ISO Standard Compliance – zakonisht përputhshmërinë me standardet europiane si EN 14511, EN 378, EN 14825 (efikasitet energjetik, siguria e sistemeve ftohëse). RoHS / WEEE – për kufizimin e substancave të rrezikshme dhe riciklimin (fletët e pajtueshmërisë (Declaration of Conformity – DoC) nga prodhuesi. Pajisja duhet të ketë CE, ErP, etiketë energjetike dhe/ose deklarata konformiteti.

5	Kondicioner Inverter mural 24000 BTU/h	Kondicioner Inverter Mural 24000 BTU/h; Kapaciteti termik Ftohje Mesatar: 7.1 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Mesatar 8.2 kW; Fuqia elektrike 2.6-2.57 kW; SEER=5.8-6.8, SCOP=4.0-4.18; EER=2.64-2.93; COP=3.19-3.6; Sasia e ajrit Mesatar ftohje: 600-918 m ³ /h; Sasia e ajrit Mesatar ngrohje: 700-1040 m ³ /h; Niveli Zhurmës Minimumi 30-40 dB(A); Temperatura e punës Minimumi -15°C; Klasi Energjisë A+++ / A++ gaz R32, wifi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN/ISO Standard Compliance – zakonisht përputhshmërinë me standardet europiane si EN 14511, EN 378, EN 14825 (efikasitet energjetik, siguria e sistemeve ftohëse). RoHS / WEEE – për kufizimin e substancave të rrezikshme dhe riciklimin (fletët e pajtueshmërisë (Declaration of Conformity – DoC) nga prodhuesi. Pajisja duhet të ketë CE, ErP, etiketë energjetike dhe/ose deklaratë konformiteti.
---	--	---

Shenim* Referencat ndaj standarteve EN do të konsiderohen të plotësuara edhe në rastet kur artikulli është i certifikuar sipas standartit ekuivalent SSH EN i adoptuar si standart shqiptar për sa kohë standarti është teknikisht identik ose ekuivalent me standartin EN të kërkuar.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues **Shërbimi Social Shtetëror**, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Neni 36 pika 3 percakton: 3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

Duke ju referuar nenit 36 autoriteti kontraktor përfitues **Shërbimi Social Shtetëror**, ka hartuar specifikimet teknike të cilat shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Ne hartimin e secifikimeve teknike është pasur në konsideratë:

1. Natyra e mallrave që do të prokurohen,
 2. kushtet e përdorimit të tyre në institucionet perkatese,
 - 3 kërkesat për siguri, cilësi dhe qëndrueshmëri.
- Specifikimet teknike synojnë të garantojnë realizimin e një procedure prokurimi transparente, efektive dhe të barabartë, duke mundësuar blerjen e produkteve që përmbushin kërkesat teknike dhe funksionale të AK dhe që garantojnë përdorim të sigurtm cilësor dhe afatgjatë.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT

